

**Konferencë për Shtyp e Qendrës Evropiane për të Drejtat e Romëve; Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare (QNLQ); Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA); Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS).**

**DISKRIMINIMI I FËMIJËVE ROMË DHE EGJIPTIANË NË SHTËPINË E FËMIJËS SHKOLLOR NË SHKODËR**

**Ankesë drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi**

Pasqyrë Informuese



**Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve (ERRC)** është një organizatë ndërkombëtare e së drejtës së interesit publik, me drejtues romë, e cila punon për të luftuar racizmin ndaj romëve dhe shkeljen e të drejtave të njeriut të romëve përmes procesit strategjik të gjyqimit, zhvillimit të studimeve dhe politikave, si dhe edukimit për avokaci dhe të drejtat e njeriut.

**Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare (QNLQ)** ka si mision mbështetjen, ndihmën, dhe ofrimin e edukimit mbi ligjin të qytetarëve, duke pasur si përparësi gratë dhe vajzat për të rritur aksesin e tyre në institucionet publike dhe veçanërisht në sistemin e drejtësisë.



**Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)** është një organizatë e pavarur jofitimprurëse në formën e një qendre. Misioni i TLAS-it është plotësimi i nevojave ligjore dhe sociale të njerëzve në nevojë, edukimi dhe ndërgjegjësimi i shoqërisë shqiptare mbi shtetin e së drejtës dhe të drejtat e njeriut; ndërmarrja e nismave për përmirësimin e sistemit ligjor, zhvillimin e komunitetit dhe forcimin e demokracisë në Shqipëri.



**Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA)** punon për të promovuar respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe të të rinjve, për mbrojtjen e tyre nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi, për zhvillimin e të drejtave të fëmijëve dhe të të rinjve në Shqipëri dhe për rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të të rinjve në nivel kombëtar dhe lokal përmes lobimit dhe avokacisë, si dhe përmirësimit të politikave dhe legjislacionit; për ngritjen e kapaciteteve, për informim dhe studime, si dhe për krijimin e modeleve të mira të shërbimeve të kujdesit për fëmijët dhe për mbrojtjen e tyre. CRCA-ja promovon zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe të të gjitha standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

---

- Vazhdim -

## I. FAKTET BAZË TË ANKESËS

- 1) **Fëmijët romë dhe egjiptianë janë të mbipërfaqësuar në Shtëpinë e Fëmijës Shkollor të Shkodrës.** Sistemi nuk ka arritur të ndalojë institucionalizimin dhe një nga pasojat e kësaj praktike të vazhdueshme është tashmë **mbipërfaqësimi i fëmijëve romë dhe egjiptianë në këtë institucion.** Në këtë institucion ndodhen 1.5 herë më shumë fëmijë romë dhe egjiptianë nga sa duhet të kishte në bazë të totalit të popullatës rome dhe egjiptiane në Shkodër dhe në qarqet e tjera nga vijnë fëmijët e këtij institucioni. Të dhënat zyrtare tregojnë një mbipërfaqësim të fëmijëve romë dhe egjiptianë në masën prej 58.8% në këtë institucion. Popullsia rome e Shqipërisë në raport me popullsinë e përgjithshme është 0.3%, kurse ajo egjiptiane 0.12%. Këto shifra tregojnë një mbipërfaqësim të qartë të fëmijëve romë dhe egjiptianë në këtë institucion të kujdesit social. Ndonëse në disa raste kanë qenë vetë familjarët e fëmijëve që i kanë kërkuar institucionit pranimin e fëmijëve të tyre për shkak të problemeve që kanë me ofrimin e një mirëqenieje materiale atyre, e vetmja zgjidhje e duhur në ato rrethana është mbështetja e atyre familjeve që ato t'i mbajnë fëmijët në gjirin e tyre. Në fakt, autoritetet në vend që të ofrojnë këtë lloj ndihme, e përkeqësojnë edhe më shumë përjashtimin e romëve dhe egjiptianëve duke i futur fëmijët e tyre në institucione kujdesi. Kjo çon në **diskriminim të tërthortë**: ajo çka duket si një praktikë neutrale po përbën një ndikim të shpërpjesëtuar tek romët dhe egjiptianët; duke qenë se kjo praktikë është e pajustifikueshme, ajo përbën diskriminim racor.
- 2) **Kjo ankesë bazohet edhe te mungesa e rasteve të kthimit të fëmijëve romë dhe egjiptianë në familjet e tyre biologjike.** Jemi informuar se në vitin 2015, në Shkodër janë kthyer 5 fëmijë jo-romë dhe jo-egjiptianë në familjet e tyre biologjike. Asnjë fëmijë rom apo egjiptian nuk është kthyer në familjen e vet biologjike në vitet 2014<sup>1</sup> dhe 2015<sup>2</sup>. Nuk ka asnjë rast të fëmijëve romë apo egjiptianë që t'i jetë ofruar kujdes alternativ përmes një familjeje kujdestare në vitet 2013, 2014, dhe 2015. Kjo përbën diskriminim të tërthortë ndaj fëmijëve romë dhe egjiptianë në lidhje me të drejtën e tyre për jetë private dhe familjare.

## II. LEGJISLACIONI KU BAZOHET KJO ANKESË

<b>Baza ligjore</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë</li></ul>
<b>Akte Ndërkombëtare</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, ratifikuar me Ligjin Nr.8137, datë 31.7.1996.</li><li>• Konventa për të Drejtat e Fëmijës, ratifikuar më 27 shkurt 1992.</li><li>• Konventa për Marrëdhëniet me Fëmijët</li></ul>
<b>Legjislacioni</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Ligji Nr.10221, datë 4.2.2010, „Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Neni 1, 3,32.</li><li>• Ligji Nr.10347, datë 4.11.2010, “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”</li><li>• Ligji Nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar.</li><li>• Ligji Nr.139/2015, „Për qeverinë vendore”, Neni 10, 14, 24.</li><li>• VKM Nr.839, datë 3.12.2014, „Për shtesa dhe ndryshime në VKM Nr.425, datë 27.6.2012 „Për kriteret e dokumentacionin e nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe private të kujdesit social”.</li><li>• VKM Nr. 89, datë 26.1.2012 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave të shërbimeve të kujdestarisë”.</li><li>• VKM Nr.659, datë 17.10.2005, “Për standardet e shërbimeve të kujdesit social për fëmijët në institucionet rezidenciale”.</li><li>• VKM Nr.658, datë 17.10.2005, “Për standardet e shërbimeve shoqërore”</li></ul>

- Vazhdim -

<sup>1</sup> I referohet përgjigjes së Shtëpisë së Fëmijës Shkollor të Shkodrës, nr.132/1.Prot, datë 23.3.2016.

<sup>2</sup> Shkresa zyrtare nr.95, datë 11.05.2016 (Përgjigja).

### III. PËRJASHTIM SOCIAL QË ÇON NË MBIPËRFAQËSIM –

- **Mosparandalimi nga ana e shtetit i institucionalizimit të fëmijëve romë dhe egjiptianë** përbën mosadresimin nga ana e tij të problemeve të ngutshme sociale dhe ekonomike me të cilat përballen romët dhe egjiptianët për shkak të diskriminimit, probleme që çojnë në një mbipërfaqësim të fëmijëve romë dhe egjiptianë në këtë institucion.
- **Masa e ndihmës ekonomike që përfitojnë familjet është e pamjaftueshme që ata t'u sigurojnë fëmijëve mirëqenie.** “Ndonëse është përmirësuar mbulimi i personave jashtëzakonisht të varfër, masa e ndihmës mbetet e vogël dhe vetëm 2,000 familje rome dhe egjiptiane janë të përfshira në skemën e ndihmës ekonomike nga një total prej 80,000 familjesh...”<sup>3</sup>.
- **Sa i përket strehimit, shteti ka dështuar në ofrimin e strehimit të përshtatshëm komuniteteve rome dhe egjiptiane.** Sipas studimit të OSFA-së, 67% e familjeve rome jetojnë në shtëpi private përdhese, pesë për qind në banesa të përshtatura si ish-magazina, kapanone etj, 15% në baraka dhe vetëm 13% në blloqe apartamentesh. Në 38% të rasteve, të gjithë anëtarët e familjes jetojnë në një dhomë të vetme. Studimi i PNUD-it konstatoi se shumica e romëve jetojnë në ndërtesa të dëmtuara (38,4%) ose në baraka (20,8%), krahasuar me 45,8% dhe 10,9% të egjiptianëve<sup>4</sup>.

### IV. PROBLEMI NUK ËSHTË THJESHT ÇËSHTJE VARFËRIE

**Nuk është marrë asnjë masë efikase për të mos lejuar një numër kaq të madh fëmijësh romë dhe egjiptianë që të vendosen në institucione të kujdesit social. Mbipërfaqësimi i fëmijëve romë dhe egjiptianë në institucionet e kujdesit social përbën një shkelje të të drejtave të njeriut dhe një nga simptomat më të mprehta të diskriminimit me të cilin përballen romët dhe egjiptianët.** Kjo ankesë vjen pas draft-raportit të Avokatit të Popullit të 30 qershorit, i cili konstatoi se punonjësit e institucionit të kujdesit social të Shkodrës shfaqin sjellje diskriminuese ndaj fëmijëve romë dhe egjiptianë.

Varfëria në vetvete nuk mund të jetë kurrë shkak i marrjes në kujdestari të fëmijëve. Kur romët dhe egjiptianët preken në mënyrë disproporcionale, vendosja e fëmijëve të varfër në institucione të kujdesit social çon në diskriminim të tërthortë dhe tregon dështimin e shtetit në ofrimin e mbështetjes së nevojshme familjeve për rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre<sup>5</sup>. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka thënë në shumë raste: **Nuk mund të rrezikohet familja për shkak se fëmijët e saj jetojnë në varfëri.** Prandaj, shteti duhet të luajë një rol kryesor, duke u ofruar familjeve ndihmë dhe mbështetje në forma materiale dhe forma të tjera ekonomike, duke e konsideruar familjen prioritet. Nëse shteti nuk e bën këtë, ajo që e pret Shqipërinë pas kësaj është dënimi nga Gjykata Evropiane. Procesi i mbështetjes së familjeve në vështirësi nuk është respektuar nga qeveria vendore dhe nga shërbimet sociale para vendosjes së fëmijëve në institucionin e Shtëpisë së Fëmijës Shkollor të Shkodrës<sup>6</sup>.

Autoritetet lokale nuk i kanë përmbushur detyrimet e tyre të ofrimit të shërbimeve sociale komunitetit<sup>7</sup>. Edhe mungesa e shërbimeve sociale në bashkitë përkatëse apo njësitë administrative ka çuar në pasoja negative mbi familjet, duke i bërë ato që të udhëtojnë shpesh për t'u takuar më fëmijët e tyre, larg vendbanimit të tyre.

- Vazhdim -

<sup>3</sup> MMSR, Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020, fq.39. Bazuar në të dhënat e MMSR-së për gjashtëmujorin e parë të vitit 2014.

<sup>4</sup> Referuar MMSR-së, Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020, fq.39. Bazuar në të dhënat e MMSR-së për gjashtëmujorin e parë të vitit 2014, të dhënat nga studimi socio-ekonomik i PNUD-it/BB/KE2011.

<sup>5</sup> Shih Vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 00-2012-2472, datë 22.05.2012.

<sup>6</sup> Ligji për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, Neni 29.

<sup>7</sup> Ligji Nr.44/2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, Neni 4, pika 6; VKM Nr.659, datë 17.10.2005, „Për standardet e shërbimeve të kujdesit social për fëmijët në institucione rezidenciale”. Neni 42/1 i Ligjit Nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”

## V. PALËT PËRGJEGJËSE

- Ne konstatojmë se bashkitë nga vijën fëmijët janë përgjegjëse për diskriminimin e tërthortë me të cilin ata përballen (bashkitë Tiranë, Mallakastër, njësi administrative e Ballshit, bashkia Kamëz, bashkia Durrës). Ato janë, gjithashtu, përgjegjëse edhe për mosushtrimin e së drejtës së tyre për të jetuar me familjet biologjike dhe për mosofrimin e shërbimeve alternative si kujdesi birësues, etj., sipas procesit të vendosur të kujdesit social shtetëror.
- Bashkia e Shkodrës është përgjegjëse si administratorja e drejtpërdrejtë e këtij institucioni dhe shërbimi.
- Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror kanë detyrimin që të bashkëpunojnë me administratorët socialë të bashkive për ofrimin e shërbimeve që kanë për qëllim mbështetjen e familjeve të disavantazuara.
- Ofruesit e shërbimeve për fëmijë kanë përgjegjësinë që të mbajnë kontakte me njësitë për mbrojtjen e fëmijëve sa i përket zbatimit të planeve individuale të fëmijëve, duke lehtësuar kontaktet midis fëmijëve dhe familjeve, etj.
- Shtëpia e Fëmijës Shkollor të Shkodrës është përgjegjëse për mungesën e një bashkëpunimi efikas me bashkitë me synim mbështetjen e familjeve të fëmijëve romë dhe egjiptianë.
- Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë është përgjegjëse për mosbashkëpunimin efikas me autoritetet vendore në lidhje me ofrimin e alternativave për mbështetje të familjeve romë dhe egjiptiane. Ministria së bashku me Shërbimin Shtetëror Social janë përgjegjëse për mosmonitorimin efikas të standardeve sociale në institucionet e kujdesit social dhe sidomos për mungesën e vizionit për një plan për të ardhmen për fëmijët që kalojnë një kohë të gjatë në institucionet e kujdesit social.
- Boshllëqet në kuadrin ligjor në lidhje me rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm në kujdesin social për fëmijët kanë ndikuar negativisht të fëmijët romë dhe egjiptianë në këtë institucion rezidencial të kujdesit social. Ky është një problem që pranohet edhe nga sistemi.

**I kërkojmë Komisionierit për Mbrojtjen nga Diskriminimi që të konstatojë këtë situatë diskriminuese për shkak të etnisë së atyre që preken prej saj, t'u rekomandojë institucioneve përgjegjëse marrjen e masave efikase për t'i dhënë fund kësaj situatë dhe për të marrë masa me qëllime dhe afate të qarta për mbështetjen e familjeve të fëmijëve romë dhe egjiptianë të vendosur në këtë institucion.**

Korrik 2016